



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

Numri i lëndës: 2019:270811

Datë: 27.05.2024

Numri i dokumentit: 05735338

E.nr.93/22

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, me gjyqtarin Faton Ajvazi, duke vendosur në çështjen juridike përmbarimore të debitorit të kundër përmbarimit Kolegji “A.Xh.”, me seli në Ferizaj, tani Kolegji “U.” O.P, me seli në Ferizaj, të cilin e përfaqësojnë me autorizim av Korab Rexhepi dhe av Valmir Zhjeqi, që të dy nga Prishtina, kundër kreditorit të kundër përmbarimit Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve – Inspektorati i Punës, të cilën me autorizim e përfaqëson Avokatura Shtetërore, me datë 27.05.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

PËRFUNDON procedura përmbarimore në lëndën **E.nr.93/22**, për shkak të përmbushjes së kërkesës së debitorit të kundër përmbarimit.

A r s y e t i m i

Gjykata Themelore në Ferizaj, me aktvendimin E.nr.93/22, të datës 22.09.2022, e ka pranuar në tërësi propozimin për kundër përmbarim të debitorit Kolegji “A.Xh.”, me seli në Ferizaj, tani Kolegji “U.” O.P, kundër kreditorit Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve – Inspektorati i Punës, me të cilin e ka urdhëruar kreditorin që debitorit t’ia kthej mjetet edhe atë shumën e mjeteve prej 2,449.15 euro, shumën prej 156 euro, në emër të përpilimit të propozimit për kundër përmbarim dhe taksën gjyqësore në shumë prej 30 euro.

Kundër aktvendimit mbi caktimin e përmbarimit të datës 22.09.2022, kreditori Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve – Inspektorati i Punës, ka ushtruar ankesë dhe Gjykata e Apelit e Kosovës në Prishtinë, me aktvendimin C.A.P.nr.7669/2022, të datës 26.04.2024, e ka refuzuar ankesën e kreditorit si të pabazuar dhe e ka vërtetuar aktvendimin E.nr.93/22, të datës 22.09.2022.

Meqenëse aktvendimi mbi lejimin e përmbarimit është bërë i plotfuqishëm dhe i ekzekutueshëm, gjykata me aktvendimin e datës 24.05.2024, e ka urdhëruar Thesarin e Kosovës pranë Ministrisë së Financave, Punës dhe të Transfereve, që nga mjetet e kreditorit ta transferoj shumën e përgjithshme të mjeteve prej 2,635.15 euro, në llogarinë e debitorit të kundër përmbarimit.

Meqenëse debitori i kundër përmbarimit e ka realizuar kërkesën e tij, Gjykata konstatoj se janë përbushur kushtet ligjore nga neni 66, par 4, të LPP-së, dhe vendosi që ta përfundoj procedurën përmbarimore në këtë çështje juridike përmbarimore.

Nga sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ

E.nr.93/22, më datë 27.05.2024

GJYQTARI

Faton Ajvazi